

VENDIM
Nr. 79, datë 28.12.2015

NË EMËR TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga:

Bashkim Dedja	kryetar i Gjykatës Kushtetuese		
Vladimir Kristo	anëtar i	“	“
Vitore Tusha	anëtare e	“	“
Fatmir Hoxha	anëtar i	“	“
Gani Dizdari	anëtar i	“	“
Fatos Lulo	anëtar i	“	“
Sokol Berberi	anëtar i	“	“

me sekretare Edmira Babaj, në datën 27.10.2015 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore, mbi bazë dokumentesh, çështjen me nr. 64 Akti, që i përket:

KËRKUES: Jakup Hoxha, Zhaneta Hoxha

SUBJEKTE TË INTERESUARA: Ilir Shametaj, Albano Bicja, Indrita Bicja (Xhafa), Natasha Xhafa, Heljot Xhafa

OBJEKTI: Shfuqizimi si të papajtueshme me Kushtetutën i vendimeve nr. 763, datë 22.4.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-269, datë 8.2.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.

BAZA LIGJORE: Nenet 42, 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 6 i Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe ligji nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

GJYKATA KUSHTETUESE,

pasi dëgjoi relatorin e çështjes Sokol Berberi, mori në shqyrtim pretendimet me shkrim të kërkesve, Jakup e Zhaneta Hoxha, të cilët kanë kërkuar pranimin e kërkesës, parashtimet me shkrim të subjekteve të interesuara, Albano Bicja, Natasha Xhafa dhe Heljot Xhafa, të cilat kanë kërkuar pranimin e kërkesës, prapësimet e subjektit të interesuar, Ilir Shametaj, që ka kërkuar rrëzimin e kërkesës, si dhe diskutoi çështjen në tërësi,

VËREN:

I

1. Nga vendimet bashkëlidhur kërkesës rezulton se me kontratën e shitjes të datës 2.6.1994, shtetasit N.Xh., N.Xh., I.Xh dhe H. Xh. (përkatësisht bashkëshortët dhe dy fëmijët) kanë blerë nga Enti i Banesave një apartament të ndodhur në Tiranë, i cili është regjistruar edhe në Zyrën e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme (ZRPP) Tiranë. Kjo pronë ka qenë e bllokuar për efekt të një kredie bankare që ka marrë shtetasi N.Xh. nga Banka Agrare në vitin 1993. Disa muaj më vonë ky shtetas ka marrë hua nga shtetasi I.Sh. dhe në regjistrin e pasurisë është bërë shënimi se ajo bllokohet edhe për efekt të kësaj huaje. Duke qenë se huaja nuk është kthyer në afat, shtetasi I. Sh. i është drejtuar me padi gjykatës, e cila, me vendimin e datës 24.3.1995, ka detyruar palën e paditur të kthejë shumën e marrë dhe interesat. Ky vendim është vënë në ekzekutim nga Zyra e Përmbarimit dhe mbi apartamentin është vendosur masa e sekuestros.

2. Me kontratën e shitjes të datës 4.4.1996 kjo pronë u është shitur shtetasve A.B. dhe I.B. Po ashtu, me pretendimin se debitor është vetëm njëri nga pronarët, shtetasi N.Xh., bashkë-pronarët e tjerë i janë drejtuar gjykatës me padi për përjashtimin nga sekuestro të $\frac{3}{4}$ -ës pjesë të pandarë të apartamentit, kërkesë e cila është pranuar me vendimin e datës 18.9.1996. Nga ana e tij shtetasi A.B. ka marrë kredi bankare dhe si garanci ka vendosur në hipotekë apartamentin objekt konflikti, për të

cilin është bërë edhe shënimi përkatës në regjistrin e pasurive të paluajtshme.

3. Në vitin 1999 shtetasi N.Xh. ka marrë një hua tjetër nga shtetasi I.Sh. për shlyerjen e detyrimit bankar. Për këtë qëllim është përpiluar një kontratë huaje, e datës 29.12.1999, ku me cilësinë e huamarrësit figuronin shtetasit N.Xh., N.Xh., I.Xh. dhe H. Xh., të cilët binin dakord që në rast se shlyenin në afat të dyja detyrimet, apartamenti do të kalonte në pronësinë e huadhënësit. Duke qenë se detyrimi nuk është shlyer, sërish shtetasi I.Sh. i është drejtuar gjykatës me padi për kthimin e shumës përkatëse.

4. Shtetasi A.B., pas shlyerjes së shumës së marrë prej tij nga banka, me kontratën e shitblerjes nr. 1840 rep., nr. 252 Kol., datë 26.3.2002, ua ka shitur apartamentin kërkuësve Jakup Hoxha dhe Zhaneta Hoxha. Shtetasi I.Sh. i është drejtuar gjykatës me padi me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike, të kontratave të shitjes së apartamentit të viteve 1996 dhe 2003. Në këtë proces kërkuësit janë thirrur si palë e paditur. Me vendimin nr. 6270, datë 17.12.2004, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka vendosur rrëzimin e padisë.

5. Ky vendim është ndryshuar nga Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 22, datë 13.1.2006, e cila ka vendosur pranimin e padisë dhe konstatimin e pavlefshëm të veprimeve juridike të kryera mes palëve në procesin gjyqësor. Me vendimin nr. 8, datë 5.2.2009 (nr. 8/2009), Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur: *“Prishjen e vendimit nr. 22, datë 13.1.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjyqësor”*.

6. Me vendimin nr. 763, datë 22.4.2010 (nr. 763/2010), Gjykata e Apelit Tiranë ka vendosur: *“Ndryshimin e vendimit nr. 6270, datë 17.12.2004 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë dhe duke e gjykuar çështjen në fakt: pranimin e padisë, konstatimin e pavlefshmërisë juridike të kontratës së shitblerjes nr. 2696 rep. e nr. 971 kol, datë 4.4.1996..., të kontratës së shitblerjes nr. 1840 rep e nr. 252 kol, datë 26.3.2003...”*. Kundër këtij vendimi ka paraqitur rekurs edhe kërkuësi Jakup Hoxha. Me vendimin nr. 00-2013-269, datë 8.2.2013, Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka vendosur mospranimin e rekurseve për mungesë të shkaqeve të parashikuara nga neni 472 i Kodit të Procedurës Civile.

II

7. **Kërkuësit** i janë drejtuar Gjykatës Kushtetuese (Gjykata) me kërkesë për shfuqizimin e vendimeve gjyqësore sipas objektit të kërkesës, duke parashtruar këto shkaqe, në mënyrë të përmbledhur:

7.1 Kërkuësit janë përfshirë në këtë proces gjyqësor padrejtësisht, pa pasur dijeni se çfarë probleme të tjera mund të kishin pasur pronarët e mëparshëm, në një kohë që të gjitha dokumentet që shoqëronin pronën ishin të rregullta, konform ligjeve në fuqi, në mirëbesim ndaj organeve të shtetit dhe të garantuara nga zyra noteriale.

7.2 Në rigjykimin e çështjes Gjykata e Apelit nuk i ka marrë parasysh detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë, në kundërshtim me nenin 493 të KPC-së. Ky vendim nuk ka marrë parasysh as faktet dhe as provat e paraqitura në lidhje me blerjen e pronës nga kërkuësi, por e ka përfshirë edhe atë në situatën e detyrimeve monetare midis palëve të tjera në proces.

7.3 Neni 168/a i Kodit Civil parashikon fitimin e pasurisë me parashkrim fitues, ku për sendet e paluajtshme afati është 10-vjeçar. Kërkuësi me familjen e tij e ka blerë këtë pasuri duke qenë në mirëbesim dhe jeton aty prej 13 vjetësh.

7.4 Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit edhe pse me vendimin e mëparshëm të saj kishte lënë detyra të caktuara për Gjykatën e Apelit, duke e kthyer çështjen për rigjykim.

7.5 Me vendimet e tyre gjykatat kanë cenuar të drejtat themelore të jetesës, të pronës dhe të banimit të kërkuësve dhe familjarëve të tyre.

8. *Subjekti i interesuar, Ilir Shametaj, ka prapësuar se:*

8.1 Kërkuësit nuk kanë parashtruar asnjë argument kushtetues se përse vendimet nr. 763/2010 të

Gjykatës së Apelit Tiranë dhe nr. 00-2013-269, datë 8.2.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë u kanë cenuar të drejtën e tyre për një proces të rregullt ligjor. Pretendimet e kërkuessve për kundërshtimin e këtyre vendimeve lidhen me mënyrën e vlerësimit të provave dhe mënyrën se si gjykatat e zakonshme kanë zgjidhur çështjen e themelit.

8.2 Sipas Kodit Civil veprimet juridike absolutisht të pavlefshme nuk krijojnë asnjë pasojë juridike, ndaj kushdo që ka fituar një send të paluajtshëm mbi bazën e një veprimi të tillë duhet ta kthejë sendin në gjendjen e mëparshme.

8.3 Të dyja vendimet që kundërshtohen i plotësojnë elementet e një procesi të rregullt ligjor, në kuptim të parimeve kushtetuese të vendosura nga jurisprudenca e Gjykatës.

9. **Subjektet e interesuara**, Albano Bicja, Heljot Xhafa dhe Natasha Xhafa, të cilat bashkohen me pretendimet e kërkuessve, kanë parashtruar se:

9.1 Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë duhej të bënin një analizë të drejtë dhe objektive të provave të administruara dhe të thelloheshin veçanërisht në analizën e përmbajtjes së kontratave të shitblerjes së apartamentit.

9.2 Gjykata e Apelit ka vlerësuar si provë të rregullt kopjen e regjistrimit hipotekor të paraqitur nga Ilir Shametaj, ndërkohë që Gjykata e Shkallës së Parë e ka vlerësuar të parregullt, pasi nuk ka përsëkrim të pronës, ka inskriptime të viteve të mëparshme dhe ka bllokim të pronës mbi bazën e një kontrate noteriale të njëanshme, e cila nuk përmban vullnetin e pjesëtarëve të familjes “Xhafa”.

9.3 Gjykata e Apelit dhe Gjykata e Lartë nuk kanë respektuar parimin e paanshmërisë në gjykim, çka ka çuar në një proces të parregullt ligjor, që ka cenuar të drejtën themelore të pronës.

III

Vlerësimi i Gjykatës Kushtetuese

A. Lidhur me legjitimitimin e kërkuessve

10. Gjykata vlerëson se kërkuessit legjitimohen *ratione personae* në lidhje me pretendimet e tyre, të cilat i kanë paraqitur në kërkesë, në kuptim të neneve 131/f dhe 134/1/g të Kushtetutës dhe *ratione temporis*, pasi kërkesa është paraqitur në Gjykatën Kushtetuese brenda afatit të parashikuar nga neni 30 i ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”.

11. Në lidhje me legjitimitimin *ratione materiae*, Gjykata vlerëson se pretendimi kryesor i ngritur nga kërkuessit në rastin konkret është cenimi i standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor, pretendim i cili është shqyrtuar në vijim në këndvështrim të standardeve që imponon procesi i rregullt ligjor në kuptimin kushtetues.

B. Për pretendimin e cenimit të standardit të arsytimit të vendimit gjyqësor

12. Kërkuessit kanë pretenduar se në rigjykimin e çështjes Gjykata e Apelit nuk i ka mbajtur parasysh detyrat e lëna nga Gjykata e Lartë dhe as faktet e provat shkresore të paraqitura nga kërkuessit për sa i përket blerjes së pronës nga ana e tyre. Sipas kërkuessve, Gjykata e Apelit nuk është ndalur të vlerësojë secilën prej kontratave të shitblerjes së pronës, por ka konkluduar se të gjitha kontratat e shitjes së pronës janë të pavlefshme. Edhe Gjykata e Lartë në dhomë këshillimi ka vendosur mospranimin e rekursit, megjithëse me vendimin e mëparshëm të saj nr. 8/2009 kishte lënë detyrë që Gjykata e Apelit të analizonte me hollësi në vendim çdo kontratë të shitblerjes së pronës.

13. Gjykata ka theksuar se e drejta për një proces të rregullt ligjor, që i garantohet individit nga nenet 42 dhe 142/1 të Kushtetutës, përfshin edhe të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsytuar. Arsytimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Funksioni i një vendimi të arsytuar është t’u tregojë palëve që ato janë dëgjuar, si dhe u jep mundësinë atyre ta kundërshtojnë atë. Përveç kësaj, duke dhënë një vendim të arsytuar, mund të realizohet vëzhgimi publik i administrimit të

drejtësisë (*shih vendimet nr. 2, datë 26.1.2015; nr. 3, datë 23.1.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

14. Vendimet gjyqësore që japin gjykatat e të gjitha niveleve në përfundim të gjykimit përbëjnë aktin procedural kryesor të të gjithë procesit gjyqësor. Ato përmbledhin dhe finalizojnë përfundimisht qëndrimet që mban gjykata lidhur me çështjen në gjykim (*shih vendimet nr. 8, datë 16.3.2011; nr. 7, datë 9.3.2009 të Gjykatës Kushtetuese*). Në jurisprudencën e saj Gjykata ka theksuar domosdoshmërinë e arsytimit të vendimeve gjyqësore si një garanci për procesin ligjor. Vendimi duhet të mbështetet vetëm mbi faktet që janë paraqitur gjatë procesit gjyqësor dhe duhet të përmbajë bazën ligjore mbi të cilën bazohet zgjidhja e mosmarrëveshjes, analizën e provave, si dhe mënyrën e zgjidhjes së mosmarrëveshjes. Arsyetimi i vendimeve është element thelbësor i një vendimi të drejtë. Vendimi gjyqësor në çdo rast duhet të jetë logjik, i rregullt në formë dhe i qartë në përmbajtje. Në tërësinë e tij ai duhet konsideruar si një unitet, në të cilin pjesët përbërëse janë të lidhura ngushtësisht mes tyre. Ato duhet të jenë në shërbim dhe funksion të njëra-tjetrës. Argumentet e pjesës arsyetuese duhet të jenë të bazuara dhe të lidhura logjikisht, duke respektuar rregullat e mendimit të drejtë. Ato duhet të formojnë një përmbajtje koherente brenda vendimit, i cili përjashton çdo kundërthënie, kontradiksion të hapur ose të fshehtë. Këto argumente duhet të jenë, gjithashtu, të mjaftueshme për të mbështetur dhe pranuar pjesën urdhëruese (*shih vendimet nr. 3, datë 23.1.2014; nr. 3, datë 19.2.2013; nr. 20, datë 13.4.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

15. Zbatimi i këtij parimi është vlerësuar nga Gjykata rast pas rasti, në varësi të rrethanave konkrete të çështjes, duke analizuar nëse vendimet gjyqësore të kundërshtuara e kanë përmbushur në mënyrë të mjaftueshme detyrimin për arsytimin e vendimeve të tyre. Ajo ka verifikuar nëse vendimi i kundërshtuar është logjik, ka kundërthënie, përmban referencat në ligjin e zbatueshëm dhe nëse respekton të gjitha elementet e sipërpërmendura (*shih vendimin nr. 25, datë 10.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*). Në këtë kontekst, Gjykata ka theksuar se nuk është detyrë e saj të analizojë provat dhe faktet ku është bazuar gjykata për zgjidhjen e çështjes së themelit. Kjo mbetet detyrë funksionale e gjykatave të juridiksionit të zakonshëm. Në aspektin e kontrollit kushtetues, Gjykata verifikon nëse arsytimi i vendimit gjyqësor i ka plotësuar ose jo kriteret e përcaktuara më sipër, të cilat garantojnë të drejtën për të pasur një vendim gjyqësor të arsyetuar. Në vlerësimin e Gjykatës nuk mjafton që arsytimi të jetë formalisht i pranishëm në kuptimin grafik dhe strukturor, pasi kjo do ta bënte atë thjesht fiktiv. Arsyetimi duhet domosdoshmërisht të plotësojë kriteret minimale ligjore të përcaktuara dhe të mos ketë të meta të tilla serioze që cenojnë standardin e vendimit gjyqësor të arsyetuar (*shih vendimin nr. 55, datë 18.12.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

16. Nga rrethanat e çështjes konkrete vërehet se Gjykata e Lartë, me vendimin nr. 8/2009, ka vendosur prishjen e vendimit nr. 22, datë 13.1.2006 të Gjykatës së Apelit Tiranë dhe dërgimin e çështjes për rigjykim në po atë gjykatë, por me tjetër trup gjykues. Ky vendim është prishur, pasi Gjykata e Apelit ishte shprehur përtej asaj që kërkohej, duke konstatuar edhe pavlefshmërinë e kontratës fillestare të privatizimit të apartamentit, në një kohë kur nuk kishte asnjë pretendim në lidhje me këtë kontratë nga paditësi, si dhe nuk kishte arsyetuar në vendim përse kishte arritur në përfundimin se kontratat ishin të pavlefshme. Më konkretisht, Gjykata e Lartë është shprehur se Gjykata e Apelit ishte e detyruar që në vendim të bënte një analizë të hollësishme dhe të përcaktonte qartë se cilit rast të pavlefshmërisë absolute i referohen kontratat. Kjo sipas saj do të ishte shumë e rëndësishme, pasi edhe pse në të gjitha rastet veprimi juridik absolutisht i pavlefshëm nuk krijon asnjë pasojë, vetë ligjvënësi në ndonjë rast ka bërë disa përjashtime, lidhur me zgjidhjen e pasojave të pavlefshmërisë në raport me personat e tretë (*f. 6 dhe 7 të vendimit nr. 8, datë 5.2.2009 të Gjykatës së Lartë*).

17. Gjatë rigjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 763/2010, pasi ka shqyrtuar faktet e çështjes, ka vlerësuar se kontratat për tjetërsimin e pasurisë janë lidhur me mashtrim të ligjit dhe në bazë të nenit 92/b të Kodit Civil (KC) janë absolutisht të pavlefshme (duke përjashtuar kontratën e privatizimit të apartamentit). Nga përmbajtja e këtij vendimi Gjykata vëren

se në të janë pasqyruar rrethanat e çështjes, baza ligjore, dispozitivi, por jo një analizë e kontratave të shitblerjes së pronës, me qëllim evidentimin e elementeve të pavlefshmërisë së secilës prej tyre. Pra, Gjykata e Apelit nuk ka analizuar elementet e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik konkret dhe nuk ka arsyetuar se si janë plotësuar këto elemente në rastin e secilës kontratë shitblerjeje, edhe pse këto detyra ishin lënë nga Gjykata e Lartë. Gjykata e Apelit është mjaftuar me përfundimin se kontratat janë absolutisht të pavlefshme, sipas nenit 92/b të KC-së, pasi janë lidhur në mashtrim të ligjit.

18. Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. 763/2010 të Gjykatës së Apelit, nuk ka vlerësuar nëse vendimi i kësaj të fundit cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor. Gjykata në jurisprudencën e saj ka theksuar se në rastin e shqyrtimit të kërkesave individuale, në bazë të nenit 131/f të Kushtetutës, ajo udhëhiqet nga parimi i subsidiaritetit. Kontrolli i respektimit të standardeve kushtetuese për një proces të rregullt ligjor është funksion edhe i gjykatave të zakonshme, e aq më tepër i Gjykatës së Lartë. Gjykimi kushtetues synon të vlerësojë nëse procesi, si i tërë, ka qenë i rregullt, duke u ndalur në ato shkelje thelbësore, vërtetimi i të cilave do të cenonte të drejtat dhe liritë themelore të palëve në proces. Gjykata ka pranuar cenimin e parimit për një proces të rregullt ligjor në rastet kur gjykata e shkallës më të lartë, duke u bazuar në kompetencat që i jep Kodi i Procedurës, nuk ka plotësuar apo nuk ka korrigjuar mangësitë dhe gabimet e gjykatave të shkallëve më të ulëta në plotësimin e standardeve dhe të elementeve të një procesi të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 47, datë 6.7.2015; nr. 5, datë 25.2. 2013 të Gjykatës Kushtetuese*). Në rastin konkret, Gjykata e Lartë nuk e ka kontrolluar vendimin e Gjykatës së Apelit nga pikëpamja e procesit të rregullt ligjor. Në vendimin e Gjykatës së Apelit mungon argumentimi i plotë ligjor në lidhje me pavlefshmërinë absolute të secilës kontratë të shitblerjes së pronës. Jo vetëm kaq, por Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar as në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të dhëna prej saj nga Gjykata e Apelit gjatë rigjyqimit të çështjes. Në këtë mënyrë Kolegji Civil i Gjykatës së Lartë ka lejuar një proces të parregullt ligjor, në kushtet kur nuk ka konstatuar cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor dhe nuk e ka vlerësuar vendimin e Gjykatës së Apelit në këtë aspekt për të korrigjuar apo plotësuar më pas këtë mangësi.

19. Për rrjedhojë, Gjykata vlerëson se pretendimi i kërkuar për cenimin e standardit të arsyetimit të vendimit gjyqësor është i bazuar dhe arrin në përfundimin se vendimi i Gjykatës së Lartë është i cenueshëm në këndvështrimin kushtetues¹.

PËR KËTO ARSYE,

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të neneve 131/f dhe 134/1, shkronja “g”, të Kushtetutës, si dhe të nenit 72 të ligjit nr. 8577, datë 10.2.2000, “Për organizimin dhe funksionimin e Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Shqipërisë”, njëzëri

VENDOSI:

- Pranimin e pjesshëm të kërkesës.
 - Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të vendimit nr. 00-2013-269, datë 8.2.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë.
 - Dërgimin e çështjes për rishqyrtim në Gjykatën e Lartë.
- Ky vendim është përfundimtar, i formës së prerë dhe hyn në fuqi ditën e botimit në Fletoren Zyrtare.

Anëtarë: Bashkim Dedja (kryetar), Vitore Tusha, Vladimir Kristo, Gani Dizdari, Fatmir Hoxha, Sokol Berberi, Fatos Lulo

¹ Gjyqtarët S. Berberi, V. Tusha, F. Hoxha dhe F. Lulo, përveç shfuqizimit të vendimit nr. 00-2013-269, datë 8.2.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, kanë votuar edhe për shfuqizimin e vendimit nr. 763, datë 22.4.2010 të Gjykatës së Apelit Tiranë.

MENDIM PARALEL

1. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të vendimit nr. 00-2013-269, datë 8.2.2013 të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë, në ndryshim nga shumica e shoh edhe nën një këndvështrim tjetër, për arsyet si më poshtë vijojnë.

2. Nga rrethanat e çështjes, sikurse ka konstatuar edhe shumica, vërehet se:

a) kërkuessit janë thirrur si palë e paditur në procesin gjyqësor me objekt konstatimin e pavlefshmërisë absolute të veprimeve juridike, të kontratave të shitjes së apartamentit të viteve 1996 dhe 2003. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë, me vendimin nr. 6270, datë 17.12.2004, ka vendosur rrëzimin e kërkesëpadisë;

b) vendimi nr. 22, datë 13.1.2006 i Gjykatës së Apelit Tiranë është prishur nga vendimi nr. 8/2009 i Gjykatës së Lartë, pasi Gjykata e Apelit ishte shprehur përtej asaj që kërkohej. Sipas Gjykatës së Lartë, Gjykata e Apelit ishte e detyruar që në vendim të bënte një analizë të hollësishme dhe të përcaktonte qartë se cilit rast të pavlefshmërisë absolute i referohen kontratat (*shih paragrafin nr. 16 të vendimit të shumicës*).

c) Ndërkohë gjatë rigjykimit të çështjes, Gjykata e Apelit Tiranë, me vendimin nr. 763/2010, pasi ka shqyrtuar faktet e çështjes, ka vlerësuar se kontratat për tjetërsimin e pasurisë janë lidhur me mashttrim të ligjit dhe si të tilla në bazë të nenit 92/b të Kodit Civil (KC) janë absolutisht të pavlefshme (duke përjashtuar kontratën e privatizimit të apartamentit). Në këtë vendim nuk është bërë një analizë e kontratave të shitblerjes së pronës, me qëllim evidentimin e elementeve të pavlefshmërisë së secilës prej tyre. Gjykata e Apelit nuk ka analizuar elementet e pavlefshmërisë absolute të veprimit juridik konkret dhe nuk ka arsyetuar se si janë plotësuar këto elemente në rastin e secilës kontratë shitblerjeje, edhe pse këto detyra ishin lënë nga Gjykata e Lartë (*shih paragrafin nr. 17 të vendimit*);

ç) Sipas shumicës, Gjykata e Lartë, e cila ka vendosur mospranimin e rekursit ndaj vendimit nr. 763/2010 të Gjykatës së Apelit, nuk ka vlerësuar nëse vendimi i kësaj të fundit cenon standardin e arsyetimit të vendimit gjyqësor, pavarësisht se këtij vendimi i mungon argumentimi i plotë ligjor në lidhje me pavlefshmërinë absolute të secilës kontratë të shitblerjes së pronës. Jo vetëm kaq, por Gjykata e Lartë nuk ka verifikuar as në lidhje me zbatimin e udhëzimeve të dhëna prej saj nga Gjykata e Apelit gjatë rigjykimit të çështjes (*shih paragrafin 18 të vendimit*).

5. Gjykata në jurisprudencën e saj lidhur me vendimet e dhëna prej Gjykatës së Lartë në dhomë këshillimi dhe referuar natyrës së gjykimit kushtetues të kërkesave individuale, ka theksuar se vetëm kur janë të pranishme pretendime që kanë të bëjnë me shkeljen e parimeve themelore të procesit gjyqësor, si dhe kur këto pretendime gjejnë pasqyrim në materialet e çështjes, atëherë vendimi i Kolegjit për mospranimin e rekursit vë në dyshim të drejtën për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet n. 19, datë 19.7.2005; nr. 22, datë 6.6.2011 të Gjykatës Kushtetuese*).

6. Gjithashtu, Gjykata ka vlerësuar rast pas rasti se duke mos marrë përgjigje në Gjykatën e Lartë për pretendimet me natyrë kushtetuese për shkak të vendimit të mospranimit të rekursit, kërkuessit i cenohet përveç së drejtës së aksesit, edhe e drejta e ankimit në kuptimin substancial, e parashikuar në nenin 43 të Kushtetutës (*shih vendimin nr. 3, datë 5.2.2014 të Gjykatës Kushtetuese*).

7. Gjykata ka theksuar se e drejta e aksesit u garanton subjekteve të drejtën t'i drejtohen një gjykate, e cila do t'i dëgjojë pretendimet e tyre dhe do të shpallë një vendim pas një gjykimi të drejtë dhe publik. Gjykata ka vlerësuar vazhdimisht se administrimi i mirë i drejtësisë fillon me garancinë që një individ të ketë akses në gjykatë për t'i siguruar atij të gjitha aspektet e një forme gjyqësore të shqyrtimit të çështjes. Në këtë kuptim, ky standard përfshin të drejtën për gjykim, ku e drejta e aksesit, që është e drejta për të vënë në lëvizje gjykatën, për çështjet civile, përbën një aspekt të saj. E drejta e aksesit në një organ gjyqësor duhet të jetë një e drejtë që lidhet me themelin dhe jo një e drejtë e pastër formale. Aksesit në gjykatë duhet të jetë substantiv dhe jo thjesht formal. Mohimi i së drejtës për t'iu drejtuar gjykatës dhe për të marrë një përgjigje përfundimtare prej saj për pretendimet e ngritura, përbën cenim të së drejtës

themelore për një proces të rregullt ligjor (*shih vendimet nr. 7, datë 27.2.2013, nr. 14, datë 26.3.2012; nr. 4, datë 23.2.2011; nr. 14, datë 3.6.2009; nr. 7 datë 11.3.2008 të Gjykatës Kushtetuese*).

8. Lidhur me të drejtën e ankimit, neni 43 i Kushtetutës parashikon se “*kushdo ka të drejtë të ankohet kundër një vendimi gjyqësor në një gjykatë më të lartë, përveçse kur në Kushtetutë parashikohet ndryshe*”. Në jurisprudencën e kësaj Gjykate e drejta e ankimit është vlerësuar si mundësi e çdo individi për të pasur mjete të caktuara procedurale për të kundërshtuar vendimin e dhënë nga një gjykatë më e ulët në një gjykatë më të lartë, duke i garantuar atij (individi) të drejtën për t’u përballur me drejtësinë në të gjitha nivelet e saj (*shih vendimet nr. 5, datë 2.3.2010, nr. 12, datë 14.4.2010, nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Pra, me Kushtetutë kujtdo i garantohet e drejta për t’u ankuar të paktën një herë kundër çdo vendimi gjyqësor të dhënë ndaj tij. Kjo garanci e rëndësishme kushtetuese është edhe një tejkalim pozitiv krahasuar me standardet që ofron në këtë drejtim Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut (*shih vendimet nr. 14, datë 5.7.2005; nr. 12, datë 14.4.2010 të Gjykatës Kushtetuese*).

9. Gjykata ka pohuar se e drejta e ankimit, e sanksionuar në nenin 43 të Kushtetutës, është një e drejtë procedurale që shërben për të mbrojtur një të drejtë substanciale. Kjo e drejtë bazohet në parimin se “*...nuk mund të ekzistojë një e drejtë pa të drejtën e ankimit*” (*shih vendimet nr. 12, datë 14.4.2010, nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*). Në funksion të ushtrimit efektiv të së drejtës së ankimit ka rëndësi të realizohet si aspekti formal/procedural, ashtu edhe ai substancial. Kërkesat procedurale të ankimit janë, para së gjithash, në funksion të aksesit që duhet të kenë individët për të ushtruar efektivisht ankimin ndaj vendimit gjyqësor. Çdo instancë ankimuese që njeh sistemi i normave procedurale civile /penale është pjesë e së drejtës së individit për të pasur akses në gjykatë (*shih vendimet nr. 30, datë 17.6.2010; nr. 14 datë 26.3.2012 të Gjykatës Kushtetuese*).

10. Nga sa më lart, në rastin në shqyrtim, jam i mendimit se Gjykata e Lartë duhet ta kalonte çështjen për shqyrtim në seancë gjyqësore. Gjykata e Lartë, pavarësisht se është e përbërë nga kolegje të ndryshme, nuk mund të mbajë për të njëjtën çështje dy qëndrime të kundërta me njëra – tjetrën. Jam i mendimit se Gjykata e Lartë, në funksion të rolit të saj si gjykatë e ligjit, si dhe të kontrollit në respektimin e standardeve kushtetuese nga gjykatat më të ulëta, duhet të mbante qëndrim të shprehur në respekt të së drejtës së aksesit në gjykatë dhe të parimit të arsyetimit të vendimit gjyqësor. Në këtë mënyrë, Gjykata e Lartë do të realizonte efektivisht edhe të drejtën kushtetuese të kërkuesve për të pasur një ankim substancial në një gjykatë më të lartë, në kuptim të nenit 43 të Kushtetutës. Gjithashtu, fakti që Gjykata e Lartë nuk ka respektuar vendimarrjen e saj të mëparshme, mendoj se krijon premisa edhe për cenimin e parimit e sigurisë juridike.

11. Si përfundim, mendoj se vendimi i Gjykatës së Lartë, krahas parimit të standardit të arsyetimit të vendimit, të evidentuar nga shumica, i ka cenuar kërkuesit edhe të drejtën e aksesit në gjykatë dhe atë të ankimit substancial.

Anëtar: Vladimir Kristo